

VLERAT E AGJËRIMIT

Hyrje

Falënderimi i takon Allahut , Atë e falënderojmë dhe vetëm prej Tij ndihmë dhe falje kërkujmë, kërkujmë mbrojtje nga Allahu prej të këqijave të vetvetes dhe veprave tona, atë të cilin e udhëzon Allahu s’ka kush që e devijon dhe atë të cilin e devijon Allahu nuk ka kush që e udhëzon, dëshmoj se nuk ka të adhuruar me të drejtë veç Allahut dhe se Muhamedi është rob dhe i dërguari i Tij, salavatet e Allahut qofshin mbi të, familjen e tij, shokët e tij dhe gjithë ata të cilët e ndjekin rrugën e tij deri në ditën e gjykimit – Lësho mëshirë dhe shpëtoi ata.

Ema ba’ d (në vijim):

Kjo broshurë e shkurtër për vlerat e agjërimit në të e kam sqaruar kuptimin e agjërimit në aspektin gjuhësor dhe atë terminologjik, pastaj vlerat e agjërimit dhe veçoritë e saj, dobitë e agjërimit dhe mirësitë e saj, vlera e muajit të ramazanit, agjërimi i tij, falja gjatë tij, veçoritë e tij- të gjitha këto me argumente.

E lus Allahun xhele shanuhu që ta bëjë këtë vepër të vogël të bereqetshme , të sinqertë vetëm për Allahun, të më bëjë dobi kjo vepër gjatë jetës dhe pas vdekjes sime, t’i bën dobi secilit lexues. Allahu është i luturi më i Mirë, më bujari në shpresë ndaj Tij, Ai na mjafton neve dhe tek Ai mbështetemi, nuk ka lëvizje e as forcë përveç se me Allahun më të Lartin, më të Madhin, salavatet, selamet dhe bekimet e Allahut qofshin mbi robin e dhe të dërguarin e Tij besnikun në shpalljen e Tij, dhe krijesa më e mirë ndaj gjithë krijesave tjera, i dërguari ynë Muhamedi, biri i Abdullahut mbi familjen , shokët, ndjekësit e tij të mirë deri në ditën e gjykimit.

Ebu Abdurahman

Seid Ibn Alij Ibn Vehf El-Kahtani. E mbaroi natën e enjte me 26.5.1427 Hixhrij.

Kapitulli i parë: Kuptimi i agjërimit gjuhësor dhe fetar

Një: Kuptimi gjuhësorë i agjërimit

1-“Esaum” apo “Sijam” – në gjuhën arabe do të thonë: abstenim nga çdo gjë, thuhet “Same nehar” – Abstenoi dielli, dmth kur perëndon dielli, Allahu thotë për Merjemen paqa e Allahut qoftë mbi të:

“ Unë jam zotuar në të Gjithëmëshirshmin se do të abstenoj.” (Merjem:26)
Pra nga të folurit, sepse këto fjalë Merjemja i ka thënë në kontekst të të folurit, kjo është komentim i fjalës së Allahut:

“ Dhe nuk do ti flas sot asnjë njeriu.” (Merjem:26)

Poeti En-abigatu Edh-ibjani ka thënë:
Qëndron kali i abstenuar apo jo
Në mejdan të luftës vrapon e nuk ndalet

“Sijam” është infinitiv i “Same, jesumu, saumen, sijamen”

2 - Agjërimi në kuptimin e terminologjisë islame: Është thënë se është abstenim nga diçka e caktuar, gjegjësisht abstenim nga të ngrënërit të pirurit si dhe marrëdhëniet intime prej mëngjesit deri në perëndim të diellit, me nijet.

Po ashtu është thënë: Është abstenim prej disa gjërave të caktuara në kohë të caktuar.

Po ashtu është thënë: Abstenim i veçantë në kohë të caktuar në mënyrë të caktuar prej.

Është thënë: Abstenim nga ushqimi në mënyrë të caktuar.

Është thënë: Abstenim me nijet nga ushqimi dhe marrëdhëniet intime në kohë të caktuar nga personi i caktuar.

Është thënë gjithashtu: Abstenim nga të ngrënërit dhe të pirurit dhe marrëdhëniet intime në suaza të shariatit (ligjit islam) gjatë ditës në mënyrë legjislative.

Definomi më preciz i Agjërimin në aspektin islam është: Adhurim për Allahun duke u larguar me nijet nga ngrënia, pirja dhe gjërat tjera të cilat e prishin agjërimin, prej në agimin e dytë (imsak) deri në perëndim të diellit, nga personi i caktuar, me kushte të caktuara.

Kapitulli i dytë: Vlera e agjërimit dhe veçoritë e tij

Agjërimi në islam ka vlera të mëdha dhe veçori të ndryshme, prej tyre do të cekim disa si në vijim:

1 - Agjërimi është një vepër për të cilën Allahu xhele shanuhu premtan për të falje mëkatesh (magfired) dhe shpërblim të madh. Ngase Allahu thotë: “Nuk ka dyshim se për myslimanët, besimtarët e besimtare, adhuruesit e adhurueset, të sinqertit dhe të sinqertat, durimtarët dhe durimtare, të përvuajturit dhe të përvuajturat, sadakdhënësit dhe sadakdhënëset, agjëruesit dhe agjërueset, ruajtësit e nderit dhe ruajtëset e nderit, shumë

përmendësit e All-llahut e shumë përmendëset e All-llahut , All-llahu ka përgatitur falje (mëkatesh) dhe shpërblim të madh”.(Ahzab, 35)

2 - Agjërimi është më e mira për myslimanin, sikur ta dinë ai këtë çështje! Sepse Allahu thotë:” (jeni të obliguar për) Ditë të caktuara, e kush është i sëmurë prej jush ose është në udhëtim (e nuk agjëroi), atëherë ai (le të agjërojë) më vonë aq ditë. E ata që i rëndon ai (nuk mund të agjërojnë), janë të obliguar për kompensim, ushqim (ditor), i një të varfëri ai që nga vullneti jep më tepër, ajo është aq më mirë për te. Mirëpo, po që se dini, agjërimi është më i mirë për ju.”(Bekare,184).

3 - Agjërimi është një nga shkaqet e arritjes së devotshmërisë sepse Allahu xhele shanuhu thotë:” O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm.” (Bekare,183).

4 - Agjërimi është mburojë, me të cilën mbrohet robi mysliman nga zjarri i xhehenemit, siç transmeton Xhabiri radijallahu anhu se Pejgamberi salallahu alejhi ve selem ka thënë:” Zoti ynë ka thënë:Agjërimi është mburojë, me anë të së cilës mbrohet robi nga zjarri (I xhehenemit), agjërimi është i Imi dhe Unë shpërblej për të.” Gjithashtu transmeton Ka’b Ibn Uxhre radijallahu anhu dhe thotë: Më tha i dërguari Allahut salallahu alejhi ve selem :” Lus Allahun që të ruan o Ka’b Ibn Uxhre prej prijësve të cilët do të vinë pas meje, kush shkon tek ata dhe u beson gënjeshtreve të tyre dhe ju ndihmon në padrejtësinë që bëjnë, ai nuk është nga unë dhe unë nuk jam i tij, dhe nuk më gjen mua ky person tek haudi (haudi është lum në xhenet, kush pinë nga ai nuk etet asnjëherë) ndërsa ai shkon tek ata apo duke mos shkuar nuk beson në gënjeshttrat e tyre, nuk ju ndihmon në padrejtësi, ky është i imi dhe unë jam me të, ky person më gjen mua tek haudi, o Ka’b Ibn Uxhre: namazi është argument, agjërimi mburojë si kalaja, kurse sadakaja i shlyen mëkatet siç e shuan uji zjarrin, O Ka’b Ibn Uxhre nuk hyn në xhenet një njëri që është rritur me haram, për të zjarri është shumë afër, O Ka’b Ibn Uxhre njerëzit kur zgjohen janë dy lloje: e blenë vetën e tij dhe e liron atë, apo e shet vetën e tij dhe e dënon atë.” (Tirmidhiu-614). Gjithashtu Othman Ibn Ebil-As radijallahu anhu thotë: E kam dëgjuar të dërguarin e Allahut salallahu alejhi ve selem duke thënë:”Agjërimi është mburojë, sikur mburoja e ndonjërit prej jush në luftë,” pastaj vazhdon Othmani dhe thotë: fjala e fundit me të cilën më këshilloi Pejgamberi salallahu alejhi ve selem kur më dërgoi në Taif ishte:” O Othman mos e zgjat shumë namazin, sepse ne xhemat pas teje ke pleq dhe nevojtarë.” (Ahmedi26/202 nr:2673).

5 - Agjërimi është fortifikatë, e cila të mbron nga zjarri (i xhehenemit) siç transmeton Ebu Hurejra radijallahu anhu se Pejgamberi salallahu alejhi ve

selem ka thënë:” Agjërimi është mburojë dhe fortifikatë e cila të mbron nga zjarri.”

6 - Agjërimi është mburojë që të mbron nga epshi, transmeton Abdullah Ibn Mesudi radijallahu anhu dhe thotë: Na ka thënë Pejgamberi salallahu alejhi ve selem: ”O ju të rrijë, kush ka mundësi prej jush të martohet (ka epsh), le të martohet, sepse kjo e ruan atë që të mos shikoj haram dhe ia ruan organin e tij më mirë, ndërsa ai i cili nuk ka mundësi të martohet, le të agjëron sepse kjo për të do të jetë mburojë (që e mbron nga epshi)”. (Mutefekun alejhi)

7 - Ai i cili agjëron një ditë në rrugë të Allahut (xhihad), Allahu xhele shanuhu zjarrin e xhehenemit prej atij personi e largon 70 vjet. Siç transmetohet në hadithin e Ebi Seid El-Hudriut radijallahu anhu i cili thotë: e kam dëgjuar të dërguarin e Allahut salallahu alejhi ve selem duke thënë: “Kush agjëron një ditë në rrugë të Allahut, me këtë Allahu e largon zjarrin e xhehenemit nga fytyra e këtij personi shtatëdhjetë vjeshta (vjet).” (Mutefekun – Alejhi).

8 - Kush e agjëron një ditë në rrugë të Allahut, Allahu xhele shanuhu këtë person do ta largon nga zjarri i xhehenemit aq sa është largësia ndërmjet tokës dhe qiellit.” Në hadithin e Umame El- Bahili radijallahu anhu i cili transmeton se Pejgamberi salallahu alejhi ve selem ka thënë:” Kush e agjëron një ditë në rrugë të Allahut, Allahu xhele shanuhu do të bënë ndërmjet tij dhe zjarrit të xhehenemit hendek (gropë) aq sa është largësia ndërmjet tokës dhe qiellit.” (Tirmidhiu 1624). Imam Kurtubiu në lidhje me hadithin :” kush agjëron një ditë në rrugë të Allahut,...”thotë: Në respekt të Allahut që do të thotë: duke synuar me atë vepër fytyrën e Allahut, mes tjerash thuhet: se në rrugë të Allahut e ka kuptimin: xhihadi në rrugë të Allahut. Kurse Neveviu e komenton hadithin në këtë mënyrë: Në hadith tregohet vlera e agjërimin në rrugë të Allahut, atëherë kurë agjërimi nuk bën dëm, nuk ia humb forcën në luftë, nuk e dobëson luftën dhe qëllimet e saja, kurse fjala e ResulullAhut salallahu alejhi ve selem:” E largon nga zjarri”e ka për qëllim, e ruan Allahu atë person nga zjarri, kurse shtatëdhjetë vjeshta në hadith e ka për qëllim shtatëdhjetë vitet. E kam dëgjuar Ibën Bazin Allahu e mëshiroftë duke thënë: Disa dijetarë e kanë komentuar fjalën e Pejgamberit salallahu alejhi ve selem” Në rrugë të Allahut” në xhihad në rrugë të Allahut, dhe kjo vërehet qartë se është mendimi i autorit (e ka për qëllim Buhariun), në qoftë se agjërimi nuk e mundon atë, disa të tjerë kanë thënë : Fi Sebili-Lah e ka qëllimin: në respekt të urdhrave të Allahut në përgjithësi.

9 - Agjërimi është porosi e Pejgamberit salallahu alejhi ve selem, nuk ka përngjasues e as barazues. Transmeton Ebu Umameja radijallahu anhu dhe

thotë: Thashë, O i dërguari i Allahut salallahu alejhi ve selem më trego një vepër e cila do të më bën dobi, më tha:” Të këshilloj të agjërosh sepse nuk ka asgjë të barabartë me të.”Në disa transmetime tjera qëndron: se Ebu Umameja e ka pyetur të dërguarin e Allahut salallahu alejhi ve selem: cila vepër është më e mira? Tha:” Të këshilloj të agjërosh sepse nuk ka vepër që barazohet në shpërblim me të.”Në një transmetim tjetër qëndron: se Ebu Umameja ka thënë: i thashë: O i dërguari i Allahut më urdhëro të bëj ndonjë punë? Tha:” Të këshilloj të agjërosh sepse nuk ka diçka paralele me të.”(Nesaiu 2220). Kurse Ibn Hibani transmeton në sahihun e tij si në vijim: Ebu Umameja thotë: i dërguari i Allahut salallahu alejhi ve selem e përgatiti një ushtri, ndërsa unë iu afrova dhe i thashë: O i dërguari i Allahut, lute Allahun për mua të vdes si shehid.Tha:” O Allah ruaji dhe pasuroi me plaçkë luftime,” luftuam, u kthyem shëndosh dhe fituam plaçkë, kështu në të njëjtën mënyre veproji tre here, pastaj i thashë: O i dërguari i Allahut kam ardhur tek ti tre herë radhazi duke kërkuar që ta lutësh Allahun të vdes si shehid kurse ti më the:” O Allah ruaji këta dhe pasuroi me plaçkë luftime,” e ne u kthyem shëndosh dhe mirë, dhe fituam plaçkë, O i dërguari i Allahut më urdhëro me një vepër me anë të cilës do të hyj në xhenet, tha: “ Të këshilloj të agjërosh sepse nuk ka si ai.” Pas kësaj në shtëpinë e Ebu Umames gjatë ditës nuk vëreheshe tym (zjarr), vetëm se kur i vinte ndonjë mik, kur shihnin tym në shtëpinë e Ebu Umames gjatë ditës e dinin se i kanë ardhur miq. (Sahih Ibn Hiban 3425).

10 - Agjërimi është shkak për të hyrë në xhenet nga dera Rejjan, sepse Sehl Ibn Sa’di radijallahu anhu thotë: ka thënë i dërguari i Allahut salallahu alejhi ve selem:” Në xhennet është një derë që quhet Rejjan, prej së cilës hynë agjëruesit ditën e gjykimit, s’ka mundësi të hyjë askush përpos tyre. Do të thuhet: ku janë agjëruesit? Do të çohen agjëruesit dhe nuk do të hynë askush përpos tyre, e kur të hynë të gjithë mbyllet dhe askush më nuk hynë.” (Mutefekun – Alejhi) Në një transmetim tjetër qëndron : “ Xhenneti ka tetë dyer, në të ka një derë e cila e ka emrin Rejjan, në të nuk mund të hyjë askush përpos agjëruesit.” (Buhariu 3257) Transmeton Ebu Hurejra radijallahu anhu se Pejgamberi salallahu alejhi ve selem ka thënë:” Ai që shpenzon dy lloje të pasurisë në rrugën e Allahut do të thirret nga gjitha dyert e xhennetit: O rob i Allahut kjo është e mira yt, ai që është prej namazlive thirret nga dera e namazit , ai që është nga muxhahedinët (luftarët) do të thirrën nga dera e xhihadit, ai që është nga agjëruesit do të thirret nga dera e Rejjanit, ai që është nga ata që japin sadaka, do të thirret nga dera e sadakasë,” atëherë Ebu Bekri tha: O i dërguari i Allahut nënë e babë flijofsha për ty, nuk ka dëm për asnjë prej cilësdo derë që thirret, por a thirret ndonjëri nga të gjitha ato dyer? Tha:” Po dhe shpresoj që ti të jesh një

prej tyre.” (Mutefekun-Alejhi) Në një transmetim tjetër të Buhariut qëndron :” Kush shpenzon dy lloje të pasurisë në rrugë të Allahut, do ta thirrin atë rojet e xhennetit, çdo roje në derën e tij i thotë: O filan urdhëro:” (Buhariu2841) Në një transmetim tjetër të Buhariut qëndron :” Kush shpenzon dy lloje të pasurisë në rrugë të Allahut, prej çfarë do lloji të pasurisë së tij, do ta thirrin atë rojet e xhennetit, çdo roje në derën e tij i thotë: O filan urdhëro:” (Buhariu 3666).

11 - Agjërimi është njëra prej cilësive të para me anë të së cilës fitohet xhenneti. Transmeton Ebu Hurejra dhe thotë: i dërguari i Allahut salallahu alejhi ve selem ka thënë:” Kush prej jush sot agjëron?” Ebu Bekri tha : unë! Tha:” Kush prej jush sot e ka përcjellë një xhenaze?” Ebu Bekri tha: unë! Tha:” Kush prej jush sot e ka ushqyer një të varfër?” Ebu Bekri tha:unë. Tha:” Kush prej jush sot e ka vizituar një të sëmurë?” Ebu Bekri tha: unë. Pejgamberi salallahu alejhi ve selem tha:” Kur t’i praktikon ndonjëri prej jush këto punë brenda një dite hyn në xhenet.” (Muslimi 1028)

12 - Agjërimi i shlyen mëkatet. Transmeton Hudhejfeja radijallahu anhu se Pejgamberi s.a.v.s ka thënë: Sprovat të cilat i ndodhin njeriut në familje, pasuri, fëmijët dhe fqiuin e tij, i shlyen: namazi, agjërimi, sadakaja, urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqja.”(Mutefekun–Alejhi) Kjo është një nga begatitë e mëdha nga Allahu xhele shanuhu si shkak për faljen e mëkateve me anë të namazit, agjërimin, sadakasë, urdhërimin në të mirë dhe të ndaluarit nga e keqja, që nënkuptohet se besimtari është më se i nevojshëm që ti përvetëson këto veti. Këtu në hadith ka për qëllim shlyerjen e mëkateve të vogla, kurse për mëkatet e mëdha duhet të pendohet sinqerisht, me kushtet e teubes të cilat i kanë precizuar dijetarët.

13 - Agjëruetit shpërblehen nga ana e Allahut pa llogari (pa kufij).

14 - Agjërueti ka dy gëzime: njëra është në dynja kurse tjetra në ahiret.

15 - Aroma e gojës së agjëruetit tek Allahu është më e mirë se aroma e parfumit. Për këto tre veçori të agjërimin aludojnë hadithet e Pejgamberit salallahu alejhi ve selem. Një prej tyre është hadithi të cilin e transmeton Ebu Hurejra radijallahu anhu i cili thotë: i dërguari i Allahut salallahu alejhi ve selem ka thënë:” Allahu teala thotë: Çdo vepër e birit të Ademit është për të, përveç agjërimin, ai është i Imi dhe Unë shpërblej për të, agjërimi është mburojë (nga zjarri i xhehenemit), kur të jetë i agjerueshëm ndonjëri prej jush le të mos flasë fjalë të pista, as mos të zihet me as kë duke e ngritur zërin e tij, edhe në qoftë se dikush e fyen, apo donë të zihet me të, le t’i thotë: unë jam i agjerueshëm, pasha atë në dorën e të cilit është shpirti i Muhamedit, aroma e gojës së agjëruetit tek Allahu është më e dashur se aroma e parfumit, agjërueti ka dy gëzime me anë të cilave ai gëzohet: kur çel iftar, dhe kur e takon Allahun gëzohet me agjërimin e tij.” Në një

transmetim tjetër të Buhariut qëndron:” Agjërimi është mburojë, agjëruesi të mos flasë fjalë të pista, dhe të mos vepron vepra të injorantëve dhe në qoftë se dikush e fyen apo donë që të zihet me të le ti thotë: unë jam agjerueshëm (dy herë) pasha Atë në dorën e të cilit është shpirti i Muhamedit: aroma e gojës së agjëruesit tek Allahu është më e mirë se aroma e parfumit, e ka lënë ngrënien, pirjen dhe marrëdhëniet me gratë e tij për mua, agjërimi është i Imi dhe Unë e shpërblej për të, kurse ai i cili e bënë një vepër të mirë, shpërblimin e ka sa dhjetë vepra të mira.” Në një transmetim të Muslimit qëndron: “ Çdo vepër e birit të Ademit dyfishohet në shpërblim, kurse një vepër e mirë, vlen sa dhjetë të mira në shpërblim nga ana e Allahut deri në shtatëqind: Allahu xhele shanuhu thotë: Përveç agjërimit ai është i Imi dhe Unë shpërblej për të, sepse e ka lënë epshin e tij, ushqimin e tij për Mua. Agjëruesi ka dy gëzime: gëzimi i parë: gëzohet kur çel iftar dhe gëzimi i dytë: kur e takon Zotin e tij, era e gojës së agjëruesit tek Allahu është më e mirë se era e parfumit.”

Në një transmetim tjetër të imam Muslimit i dërguari i Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të thotë:” Agjëruesi gëzohet me dy kënaqësi: kur han iftar kënaqët me ngrënien e iftarit dhe kur e takon Zotin e tij gëzohet me agjërimin e tij.”(Mutefekun alejhi)

16 – Agjërimi dhe Kur’ani do të ndërmjetësojnë ditën e gjykimit për pronarët e tyre. Ngase transmeton Abdullah ibn Amri se i dërguari i Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të ka thënë:” Agjërimi dhe Kur’ani do të ndërmjetësojnë për robin ditën e kiametit. Agjërimi do të thotë: O Zot e kam ndaluar nga ngrënia dhe epshet e tij gjatë ditës më lejo të jem ndërmjetësues i tij, Kur’ani gjithashtu do të thotë: E kam ndaluar nga gjumi gjatë natës më lejo të jem ndërmjetësues i tij.

17 – Agjërimi është shkak që ndikon në largimin e vesveseve, urrejtjes, gënjeshtreve nga gjoksi i besimtarit sepse transmeton Ibni Abasi se i dërguari i Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të ka thënë:” Agjërimi i muajit të durimit dhe tre ditë gjatë çdo muaji i largojnë të këqijat e zemrës.”

18 – Agjërimi është derë nga dyert e mirësisë. Transmeton Muadh Ibni Xhebeli radijallahu anhu se i dërguari i Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të i ka thënë:” A dëshiron të tregoj për dyert e mirësisë? – i thashë: Po si jo O i dërguari i Allahut! – më tha:” Agjërimi është mburojë nga zjarri, sadakaja dhe namazi i njeriut në terin e natës i fshinë mëkatet ashtu siç e shuan uji zjarrin” dhe lexoi ajetin:”**I tërheqin trupat e tyre nga krevatet e tyre duke e lutur Zotin e tyre...**”(Sexhde : 16-17)

19 – Kujt i përfundon dita duke qenë i agjerueshëm dhe i sinqertë Allahu e shpërblen me xhenet. Transmetohet nga Hudhejfeja i cili thotë: U mbështet i dërguari i Allahut për mua dhe tha:” Kush thotë nuk meriton të adhurohet askush përveç Allahut duke kërkuar me këtë fjalë fytyrën e Allahut dhe jeta e tij të mbaron në këtë gjendje hyn në xhenet, dhe kush agjëron një ditë duke pasur për qëllim fytyrën e Allahut dhe jeta e tij mbaron në këtë gjendje hyn në xhenet.”

Nga Abdullah ibn Mesudi transmetohet se i dërguari i Allahut ka thënë:” Me të vërtetë ndonjëri prej jush do të bëj vepra të banorëve të zjarrit derisa nuk ngel mes jetës së tij dhe exhelit një bërryl (njësi matëse) por do të ngadhënjë ajo që është shkruar dhe ai do të bën vepra të banorëve të xhenetit dhe do të futet në të, kurse dikush prej jush do të bëj vepra të banorëve të xhenetit derisa nuk ngel mes tij dhe exhelit një bërryl, por do të ngadhënjë ajo që është shkruar dhe ai do të bën vepra të banorëve të xhehenemit dhe do të futet në të.”

20 – Allahu ka përgatitur dhoma të mëdha në xhenet për ata që e vazhdojnë agjërimin edhe pas ramazanit, i ushqejnë të tjerët, flasin me butësi dhe falen kur njerëzit flenë. Për këtë transmetohet nga Ebu Malik el-Eshariu se i dërguari i Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të ka thënë:” Në xhenet ka dhoma të cilat nga jashtë duken çfarë ka brenda dhe nga brenda duket se çfarë ka jashtë, Allahu i ka përgatitur ato për ata të cilët i ushqejnë të varfrit, flasin me njerëzit me butësi, vazhdojnë agjërimin edhe pas ramazanit, shpërndajnë selamin dhe falen natën ku të tjerët janë në gjumë.”

Ai i cili i bën këta punë të cilët u cekën në këtë hadith i fiton si shpërblim këto dhoma. Fjala “Gurfeh” është shumësi i fjalës “Guref” që do të thotë: dhoma të larta me pamje shumë të bukur, në kulminacion të pastërtisë, dhoma të tejdukshme ku të mundësohet të shohësh çfarë ka jashtë, janë të posaçme për ata të cilët kanë sjellje të mirë me njerëzit e posaçërisht për ata të cilët flasin fjalë të mira sepse këta janë robërit e Mëshiruesit të cilët ecin në tokë me modesti e kur injorantët u drejtohen atyre, këta u përgjigjen me fjalën selam-paqë. E gjithë kjo vlen për ata të cilët i ushqejnë të tjerët pa marrë parasysh a janë familjet e tyre, të varfrit, miqtë e kështu me radhë. Këto dhoma janë edhe për ata të cilët vazhdimisht agjërojnë edhe jashtë muajit të ramazanit, së paku të agjëron tre ditë në muaj madje janë edhe për ata të cilët falen natën në kohë ku të gjithë i ka kapluar gjumi. Vlen të potencohet këtu fakti se ata besimtarë që falen natën dhe janë larg syve të njerëzve tek këta syfaqësia- rijaja është larg që do të thotë se kush vepron në këtë mënyrë e ruan nijetin e tij që ai të jetë sa më i sinqertë për Allahun.

Gjithashtu këta dhoma janë për ata që e përhapin selamin, atyre që i njohin dhe atyre që nuk i njohin, pra në të njëjtën kohë ky hadith bën nxitje që besimtarët të stolisen më këto cilësi apo vepra të larta, shpërblimi i të cilëve janë dhoma të larta e të bukura në xhenet.

21 – Lutjet e agjëruesit nuk refuzohen derisa të bën iftar, transmeton Ebu Hurejra Allahu qoftë i kënaqur me të dhe thotë se i dërguari i Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të ka thënë:” Tre personave nuk u refuzohen lutjet: Prijësit të drejtë, agjëruesit derisa të çel iftar, atij që i është bërë padrejtësi, Allahu e ngritë këtë lutje mbi retë dhe ia hap dyert i qiellit dhe thotë Zoti: Pasha Krenarinë time do ta ndihmoj edhe në qoftë se zgjatë.”

22 – Gjithashtu nuk i refuzohen lutjet që agjëruesi i bënë gjatë të hapurit të iftarit. Transmetohet nga Abdullah Ibni ebi Melijke Allahu qoftë i kënaqur me të i cili thotë: Ka thënë i dërguari i Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të:” Me të vërtetë lutjet e agjëruesi gjatë të hapurit të iftarit nuk refuzohen.” Ibni ebi Melijke thotë: E kam dëgjuar Abdullah ibn Amrin Allahu qoftë i kënaqur me të kur hapte iftar duke thënë: O Allah të lutem Ty me mëshirën Tënde me anë të së cilës ke përfshirë çdo gjë të më falësh mua.

Në disa transmetime tjera të Tirmidhiut që u cek para kësaj pike thuhet:” Tre personave duatë nuk u refuzohen: Prijësit të drejtë, agjëruesit kur hap iftar dhe duaja e atij të cilit i është bërë padrejtësi.”

Këtë hadith e përforcon hadithi i Ebu Umames se i dërguari i Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të ka thënë:” All-llahu i Lartësuar gjatë çdo iftarit i liron (shpëton) disa njerëz nga zjarri i xhehennemit.”

23 – Përgatitja e ushqimit për agjëruesit ka shpërblim të madh. Transmeton Zejd ibnu Halid el-Xhuheni Allahu qoftë i kënaqur me të se i dërguari i Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të ka thënë: “Ai që i ofron iftar agjëruesit, ka shpërblim sikur shpërblimi i agjëruesit duke mos u pakësuar asgjë nga shpërblimi i agjëruesit.”

24 – Për shkak të vlerës së madhe të agjërimit Allahu agjërimitin e ka bërë shkak për faljen e mëkateve siç do ta përmendim në vijim:

- (Fidjetul – edha) Ruajtja e kokës në ihram gjatë Haxhit, kompensimi i kësaj është: thotë Allahu në Kuran:” **E mos i ruani kokat tuaja derisa të arrij kurbanin vendin e caktuar, por kush është i sëmure prej jush ose ka mundim koke (e ruhet para kohe), kompensimi është agjërimiti sadaka ose Kurban.**”(el-Bekare:196)

– Kush nuk ka të holla të thet kurban gjatë Haxhit, si kompensim agjëron tre ditë në ditët e Haxhit dhe shtatë ditë kur të kthehet në vendlindje, siç ka thënë Allahu:” **Ai i cili e bën umren para haxhit duhet të thet kurban që i vjen më lehtë, mirëpo nëse nuk ka le të agjëroj tre ditë gjatë haxhit dhe shtatë ditë kur të kthehet në shtëpi, këto janë dhjetë ditë të plotë, kjo**

vlen për ata persona të cilët nuk janë mekkasë (që nuk banojnë afër shtëpisë së shenjtë Qabesë)."

– Shpagim i gabimit në vrasjen pa qëllim sepse Allahu thotë në Kur'an:" E në qoftë se i mbyturi është nga ai popull që keni marrëveshje me të, atëherë është obligim shpagimi i gjakut që i dorëzohet familjes së tij dhe lirimi i një robi besimtarë, e kush nuk ka mundësi (të liroj një rob) le të agjëroj dy muaj rresht, si pendim për Allahun, Allahu është më i Dituri, Ligjdhënësi më i drejt."(En-Nisa:92)

d) - Shpagim gjatë zotimit sepse Allahu në Kur'an thotë:" **Allahu nuk do t'ju ndëshkojë ju për ato gjëra të paqëllimshme në betimet tuaja, por Ai do t'ju ndëshkojë për betimet me qëllim dhe për të shlyer një betim**(të qëllimshëm), **ushqeni dhjetë të varfër në atë masë sa keni ushqyer edhe familjet tuaja, ose i vishni ata, ose çlironi një skllav. Por kushdo që nuk mund ta përballoj këtë, atëherë ai duhet të agjëroj tri ditë. Kjo është shlyerja për betimet e bëra dhe ruani betë tuaja**(mos u betoni shumë)."(El-Maide: 89)

– Dëmshtëpërblim për atë që gjuan duke qenë në ihram gjatë Haxhit sepse Allahu ka thënë:" O ju që besuat, mos e mbytni gjahun duke qenë ju në ihram. E kush e mbytni atë me qëllim, atëherë dënimi është therrorizimi i një kafshe shtëpiake të ngjashme me atë (të egrën) që e ka mbytur. Për këtë çështje vendosin dy njerëz të drejtë nga mesi juaj, duke e bërë atë kurban për Qabe, ose (dënimi është) duke ushqyer të varfër, ose sa ai (ushqimi), agjërim, këtë për ta shijuar të keqen e punës së tij. All-llahu ka falur të kaluarën. E kush bën përsëri, (gabimin) All-llahu e dënon ashpër. All-llahu mbizotëron (çështjet), hakmerret (me dënim)."(El-Maide: 95)

- Kompensimi i Dhiharit, argument për këtë është fjala e Allahut:" Ata që krahasojnë (me nëna) dhe largohen nga gratë e veta, e pastaj zbrapsen nga ajo që kanë thënë, janë të obliguar që para se të kontaktojnë ndërmjet vete ta lirojnë një rob. Kjo është dispozitë me të cilën porositeni, e All-llahu është i njohur hollësisht me atë që ju punoni. E kush nuk gjen (rob për lirim), atëherë le të agjërojë dy muaj rresht para se të kontaktojnë, e kush nuk mundet, atëherë le t'i ushqejë gjashtëdhjetë të varfër. Kjo (dispozitë ju shërben) për të vërtetuar ju se besoni All-llahun dhe të dërguarin e Tij (e jo zakonet injorante). Këto, pra janë përcaktimet e All-llahut. Ndërkaq, mohuesit kanë dënim të rëndë."(El-Muxhadele: 3-4)

Kapitulli i tretë: Dobitë e agjërimit, urtësitë e mëdha dhe dispozitat

Agjërimi ka vlera,dobi dhe urtësi të shumta madje prej tyre janë:

1 – Agjërimi është shkak për të arritur devotshmërinë, sepse epshi kur ndalohet nga ushqimi hallall me shpresë që të arrij kënaqësinë e Allahut dhe si pasojë e frikës prej dënimit të Tij të rreptë atëherë pa dyshim se do të largohet nga haramet, që nënkupton se agjërimi është shkak i arritjes së devotshmërisë, për këtë vlen të përmendet fjala e Allahut:” O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm.”(El-Bekare: 183)

Kurse i dërguari i Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të ka thënë:” Kush nuk e lë fjalën e rrejshme dhe punën me të, Allahu nuk ka nevojë që i tilli ta lë ushqimin dhe pijen e tij.”(Buhariu:1903)

2 – Agjërimi është ai i cili e bën njeriun të jetë falënderues i begative, sepse të ndaluarit e epshit, të ushqyerit, të pirit dhe gjërat tjera të cilat e prishin agjërimin, është prej begative të mëdha, pasi që vlerën e diçkaje robi e kupton kur ajo i mungon për një kohë të caktuar e kështu robit kur i kujtohet gjatë kohës kur i disponon ai bëhet falënderues ndaj Allahut, ai e shijon gjatë hapjes së iftarit freskinë e ujit, i shijon ushqimet e shumta. Për këtë falënderim aludon edhe fjala e Allahut në fund të ajetit ku flitet për agjërimin e thotë:”...**me qëllim që ju të jeni shumë mirënjohës e falënderues ndaj Tij.**”

3 – Agjërimi i paraprin natyrës njerëzore duke e larguar nga epshet e këqija, nga shkakut se njeriu kur ngopet atëherë dëshiron ti plotësoj tërë dëshirat dhe epshet e tij, mirëpo kur është i uritur nuk e pason epshin e tij sikurse kur është i ngopur. Nisur nga kjo i dërguari i Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të ka thënë:” O ju të rinj kush ka mundësi të martohet le të martohet, Sepse kjo e ruan syrin nga shikimet në haram dhe ia mbron pjesët e turpshmet, ai i cili nuk ka mundësi të martohet le të agjëroj sepse agjërimi është mburojë për të.”(Mutefekun alejh) Pra agjërimi është një nga shkaqet i cili e frenon birin e Ademit nga rënia në mëkate.

4 – Agjërimi ia mundëson zemrës që kur ta përmend Allahun dhe të mediton në Allahun, ti nënshtrohet vetëm kësaj gjëje me përkushtim, sepse njeriu kur e tepron me gjëra të lejuara zemrën e kaplon gafleti (pakujdesia ndaj të përmendurit të Allahut) dhe ndoshta ndonjë herë i ngurtësohet zemra dhe verbërohet nga të kuptuarit e të vërtetës.

5 – Me anë të agjërimin i pasuri arrin ti kuptoj begatitë e Allahut ndaj tij e ndoshta shumica e njerëzve në këtë pikë janë neglizhent.

6 – Agjërimi gjithashtu luan rol të rëndësishëm në frenimin e njeriut nga mendjemadhësia dhe kryelartësia kurse në të kundërtën tek ai më shumë kultivohet ndjenja e modestisë dhe e thjeshtësisë.

7 – Me Agjërim e përmban veten dhe pakëson mendjemadhësinë.

8 – Përmjet agjërimit kupton se duhet mëshiruar dhe gjetur mirë me të varfrit, pasi që kur agjëruesi e shijon urinë dhe etjen, kjo e bën që zemrën e tij ta mbuloj mëshira ndaj atyre që janë shpesh në këtë gjendje e si pasojë kjo e bën atë që t’u bëjë mirë të varfërve dhe të arrijë kënaqësinë dhe shpërblimin e Allahut.

9 – Agjëruesi me agjërimin e tij barazohet për një kohe me të varfrit dhe vuan ashtu siç vuajnë ata, me këtë arrihet në shpërblime të mëdha nga ana e Allahut.

10- Agjërimi i ngushton venat e gjakut, këtë e shkakton uria dhe etja e kjo nga ana tjetër është shkak që edhe shejtanit t’ia ndal qarkullimin përmes gjakut të njeriut. i dërguari i Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të thotë:” Me të vërtetë shejtani qarkullon tek njeriu ashtu siç qarkullon gjaku në trupin e tij.”(Mutefekun alejhi)

11 – Agjërimi në vete i përmbledh të gjitha llojet e durimit, pra ai në vete përmbledh: Durim në respektim të urdhrave të Allahut, sikur që janë gjërat që e prishin agjërimin. Durim ndaj asaj çfarë ka caktuar Allahu, sikur që janë uria dhe etja përmes të cilave agjëruesi arrin ta fitoj shpërblimin e durimtarëve, madje për to Allahu thotë:”...**ndërsa durimtarëve u jepet shpërblimi i tyre pa masë.**”(Zumer:10)

12 – Agjërimi rezulton me dobi shëndetësore si pasojë e pakësimit ë ushqimit dhe lëngjeve, kjo ia lehtëson punën stomakut e në këtë mënyrë Allahu i largon nga njeriu shumë sëmundje të rrezikshme për shëndetin e njeriut.

13 – Agjërimi është gjëja me anë të së cilës dalin në pah robërit e Allahut dhe pasuesit e epshit, me anë të tij njeriu tregon se sa frikohet prej Allahut, se sa i sinqertë është me Allahun kudo që të jetë. Këtë e kanë dëshmuar më mirë besimtarët në të kaluarën kur janë rrahur apo burgosur që të prishin agjërimin e tyre pa arsye dhe ata nuk e kanë bërë këtë, e pa dyshim se kjo është prej urtësive më të mëdha të agjërimit.

Katër: Vlera e muajit të Ramazanit dhe veçoritë e tij

Muaji i ramazanit ka vlerë të madhe dhe veçori me të cilat dallohet prej tyre janë:

1 – Mu në këtë muaj ka zbritur Kur’ani, thotë Allahu:” **Muaji i ramazanit është muaji në të cilin ka zbritur Kur’ani, udhëzues për njerëzit dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues i të mirës nga e keqja.**”(El-Bekare:185) Allahu e ka veçuar këtë muaj nga muajt tjerë me zbritjen e Kur’anit kjo saktësisht ndodhi natën e Kadrit më mirë thënë në dhjetë netët e fundit të ramazanit, thotë Allahu:” **Ne e kemi zbritur atë (Kur’anin) natën**

e Kadrit.”(Kadr:1) Gjithashtu Allahu ka thënë:” Ne e zbritëm atë (Kur’anin) në një natë të bekuar, Ne dëshiroam me këtë tua tërheqim njerëzve vërejtjen, e njerëzit të jenë të gatshëm.”(Duhan:3)

2 – Gjatë ramazanit kanë zbritur librat qiellorë, siç transmetohet në hadithin e Vathile ibnul Eska se i dërguari i Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të ka thënë:” Kanë zbritur fletushkat e Ibrahimit në natën e parë të ramazanit, Teurati ka zbritur pas gjashtë netëve të kaluara nga muaji i ramazanit, Inxhili natën e trembëdhjetë kurse Kur’ani ka zbritur në natën e njëzet e katërt të ramazanit.”

3 – Hapen gjatë tij dyert e xhennetit.

4 – Mbyllen gjatë tij dyert e xhehenemit.

5 – Lidhen shejtanët.

6 – Hapen gjatë tij dyert e mëshirës.

7 – Hapen gjithashtu dyert e qiellit.

8 – Gjatë muajit të ramazanit thërret një thirrës dhe thotë: O ti që do të mirën nxito, e ti që do të keqen nguro, ndalo.

9 – Allahu çdo natë gjatë ramazanit liron njerëz nga zjarri

Argument për këta shtatë cilësi të muajit të ramazanit është hadithi i Ebu Hurejres Allahu qoftë i kënaqur me të i cili transmeton se i dërguari i Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të ka thënë:” Kur hyn nata e parë e ramazanit lidhen shejtanët, mbyllen dyert e xhehenemit dhe nuk hapet asnjë derë e saj, hapen dyert e xhennetit dhe nuk mbetet mbyllur asnjë derë e saj, thërret një thirrës dhe thotë: O ti i cili kërkon të mirën nxito dhe o ti që kërkon të keqen ndalo. Allahu liron nga zjarri njerëz në çdo natë të ramazanit.” Kurse në një transmetim të imam Muslimit qëndron me këtë tekst:”...hapen dyert e mëshirës.”, Në një transmetim tjetër të Buhariut dhe Muslimit qëndron:” ...dhe lidhen shejtanët me zinxhir.”

10 – Në muajin e ramazanit gjendet një natë e cila është më e vlefshme se një mijë muaj, e kush privohet nga të mirat e kësaj nate është privuar nga të gjitha mirësitë, këtë e argumentojmë me hadithin e Ebu Hurejres Allahu qoftë i kënaqur me të thotë: Ka thënë i dërguari i Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të:” U erdhi ramazani, një muaj i bekuar, në të cilin Allahu e bëri obligim agjërimin e tij, në të hapen dyert e qiellit, mbyllen dyert e xhehenemit, lidhen djajtë me zinxhir, për Allahun në të është një natë më e mirë se një mijë muaj, e ai i cili privohet nga të mirat e saj me të vërtetë është i privuar.” Në një transmetim tjetër të imam Ahmedit qëndron:” ...në të hapen dyert e xhennetit.” Në vend të pjesës ” ...hapen dyert e qiellit.”

Transmeton gjithashtu Enesi Allahu qoftë i kënaqur me të dhe thotë: Hyri ramazani dhe i dërguari i Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të

tha:” Ky muaj u erdhi, në të është një natë më e vlefshme se një mijë muaj, kush privohet nga të mirat e saj me të vërtetë është i mohuar i tëri dhe nuk privohet nga të mirat e saj veçse i mohuari.”

11 – Gjatë muajit të Ramazanit pranohen duatë, sepse Allahu e ka përmendur duan ndërmjet ajeteve të agjërimit dhe thotë:” **Dhe kur robërit e Mi të pyesin ty (O Muhamed) për Mua (përgjigju atëherë atyre) Vërtet Unë jam afër, Unë u përgjigjem duave (lutjeve) të lutësit kur ai më drejtohet Mua me lutje (pa ndërmjetësues a ndërlidhës). Kështu pra ata le të më binden Mua dhe le të më besojnë Mua, që në këtë mënyrë të mund të udhëhiqen drejt.**”(El-Bekare:186)

Nga Ebu Hurejra apo Ebu Seidi Allahu qoftë i kënaqur me të transmetohet se i dërguari i Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të ka thënë:” Allahu liron rob nga zjarri çdo natë dhe çdo ditë dhe për çdo rob ka dua të pranuar.” Ibnu Haxheri thotë: Që ka për qëllim gjatë ramazanit.

Në një transmetim tjetër të Bezarit qëndron se transmeton Ebu Seid el Hudriu Allahu qoftë i kënaqur me të i cili thotë: se i dërguari i Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të ka thënë:” Me të vërtetë Allahu liron rob nga zjarri gjatë çdo dite dhe nate të ramazanit, gjatë natës dhe ditës ka lutje të pranuar për çdo besimtarë.”

Gjithashtu transmeton Xhabiri Allahu qoftë i kënaqur me të se i dërguari i Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të ka thënë: Allahu gjatë çdo iftari liron robër nga zjarri çdo natë.”

12 - Muaji i ramazanit është muaj i dhikrit (përmendjes së Allahut) dhe shukrit (falënderimit të Allahut), sepse Allahu këtë e ka potencuar kur ka folur për dispozitat e agjërimit dhe ka thënë:” **Kështu që ta madhëroni Allahun sepse u ka udhëzuar dhe që të jeni falënderues ndaj Tij.**”(El-Bekare:185)

13 – Muaji ramazanit është muaji i durimit, duke u bazuar në hadithin e Ibni Abasit (Allahu qoftë i kënaqur me të i cili transmeton se i dërguari i Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të ka thënë:” Agjërimi është muaji i durimit-sabrit, ai i cili agjëron çdo muaj tre ditë kjo bëhet për të shkak që atij ti largohen ngushtimet e gjoksit.” Nuk ka aspak dyshim se agjërimi i muajit të ramazanit është durim në respektimin e urdhrave të Allahut, durim mbi Kaderin-caktimin e Allahut në sprovë dhe fatkeqësi, durim ndaj etjes dhe urisë, durim ndaj haremeve apo gjërave që ia ulin vlerën agjërimit tonë, prandaj edhe për këtë durim Allahu thotë:

”...**shpërblimi i durimtarëve për ta është pa llogari.**”(Zumer:10)

14 – Agjërimi i muajit të ramazanit i shlyen mëkatet transmeton Ebu Hurejra Allahu qoftë i kënaqur me të i cili thotë se i dërguari i Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të ka thënë:” Pesë kohët e namazit,

xhumaja deri në xhuma, ramazani deri në ramazan shlyen mëkatet në qoftë se robi iu largohet mëkateve të mëdha.”(Muslimi:233)

15 – Gjatë muajit të ramazanit falen mëkatet transmeton Ebu Hurejra Allahu qoftë i kënaqur me të se i dërguari i Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të ka thënë:” Kush e agjëron ramazanin me besim në Allahun dhe me shpresë në shpërblimin e Tij i falen mëkatet e kaluara.”

16 – Muaji i ramazanit është koha më e përshtatshme në të cilën falen mëkatet dhe atij të cilit nuk i falen mëkatet gjatë këtij muaji, ky person është i nënçmuar nga Allahu, transmetohet nga Ebu Hurejra Allahu qoftë i kënaqur me të se i dërguari i Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të u ngjit në minber dhe tha: Amin, amin, amin.”- i thanë: O i dërguari i Allahut pse the kështu? – tha: Më erdhi Xhibrili dhe më tha: Nënçmuar qoftë ai i cili i ka gjallë prindit apo njërin prej tyre dhe nuk hyn në xhenet! – Unë thashë: Amin. Pastaj tha: i nënçmuar qoftë ai i cili e dëgjon emrin tënd dhe nuk dërgon salavate për ty! – Unë thashë: Amin. Pastaj tha: Nënçmuar qoftë ai i cili e arrin muajin e ramazanit dhe nuk i falen mëkatet! – Unë i thashë: Amin.”

Njashtu transmeton Ebu Hurejra Allahu qoftë i kënaqur me të se i dërguari i Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të ka thënë:” i nënçmuar është ai njeri i cili unë përmendem në praninë e tij e ai nuk dërgon salavate mbi mua, i nënçmuar qoftë ai njeri i cili hyn në ramazan dhe del prej tij e atij nuk i falen mëkatet, i nënçmuar qoftë ai njeri i cili i arin të dy prindit e tij në pleqëri dhe nuk hyn në xhenet.” Disa transmetues kanë thënë: Mendoj se tha: Njërin prej tyre.

17 – Me arritjen e ramazanit ngritën shkallët në xhennet. Transmeton Talha ibnu Ubejdullahu Allahu qoftë i kënaqur me të dhe thotë: Dy persona nga Bela që e kishin pranuar islamin për një kohë erdhën tek i dërguari i Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, Por njëri prej tyre ishte më adhures se tjetri, ky adhuresi më i madh doli në Xhihad dhe atje ra shehid kurse ky i dyti jetoi më gjatë se i pari dhe pas një kohe vdiq edhe ky. Unë (thotë Talha) e pash në ëndërr Xhennetin dhe isha pranë derës së xhennetit kur i pashë edhe këta dy persona, doli dikush prej derës dhe e thirri këtë i cili jetoi një vit më shumë dhe i dha leje të futet përpara atij tjetrit në Xhennet, e më pas i dha leje edhe atij që vdiq si shehid të futet në xhennet. Më pas u kthye kah unë dhe më tha të pres se nuk kishte ardhur akoma koha për mua. Të nesërmen Talha Allahu qoftë i kënaqur me të filloi tua rrëfejë ëndrrën e tij njerëzve, njerëzit u habitën, këtë e dëgjoji edhe i dërguari i Allahut dhe tha:” Me cilin prej tyre habiteni?” – thanë sahabët: O i dërguari i Allahut si mundet që ai që ka vdekur shehid të futet më vonë se ai tjetri i cili ka jetuar më shumë? – ai ua ktheu:” Ky a nuk ka jetuar një vit më shumë se

ai tjetri? – thanë: Po! – tha:” Ky e ka arritur ramazanin dhe është falë kaq dhe kaq gjatë vitit.” Thanë: Po! – Tha:” Dallimi mes tyre është sikurse dallimi mes tokës dhe qiellit.”

18 – Umreja në ramazan e ka shpërblimin e Haxhit me të dërguarin e Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të duke u bazuar në hadithin e Ibni Abasit Allahu qoftë i kënaqur me të i cili thotë: i dërguari i Allahut i tha një gruas prej ensareve të cilën e quanin Umu Sinan Allahu qoftë i kënaqur me te:” Çfarë të ndaloj të mos bësh haxhin me ne?” – tha ajo: Dy deve të cilat ishin të Ebu Fulanit (burrit të saj) me ta bërën haxh burri dhe djali im kurse me devenë e tretë që e kishim e vaditëm tokën tonë në shtëpi – i dërguari i Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të i tha:” Umreja në ramazan llogaritet sikur me bërë haxh.” Në një transmetim të Muslimit qëndron:” Kur vjen ramazani kryeje umren sepse umreja në ramazan është e vlefshme si Haxhi.” apo:” ..Haxh me mua.” Kurse në një tekst tjetër të Muslimit qëndron:” Kur të vjen ramazani bëjeni umren sepse umreja gjatë muajit të ramazanit llogaritet Haxh.” Dhe transmetime të ngjashme me këta të cilat na e bëjnë të ditur se këshilla e të dërguarit të Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të drejtuar umu Sinanin Allahu qoftë i kënaqur me te na e bën të ditur se umreja në ramazan ka vlerë të veçantë pra ajo e ka shpërblimin pothuajse të njëjtë sikurse shpërblimi i Haxhit, porse nuk e zëvendëson farzin e Haxhit ose nuk e shlyen detyrimin e kryerjes së Haxhit me kryerjen e umres gjatë muajit të ramazanit. Por ky hadith na shpalos edhe një nga vlerat e mëdha që ka muaji i bekuar i ramazanit se si pasojë e vlerës së madhe të tij u rritet vlera edhe veprave tjera që bëhen në të siç është rasti i umres ashtu siç shtohet vlera e një vepre kur sinqeriteti dhe përkushtimi në të janë në nivel të lartë.

Pra pasi që kuptuam se vlera e umres në ramazan e ka vlerën e Haxhit apo Haxhit me të dërguarin e Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të e pa dyshim se kjo vlen për gjithë besimtarët e jo vetëm për Umu Sinan Allahu qoftë i kënaqur me te, kjo është një nga begatitë e Allahut nga bujaria e dhe bamirësia e Tij mbi robërit e përkushtuar.

19 – Ai i cili e agjëron ramazanin llogaritet prej njerëzve të sinqertë dhe dëshmorëve duke u bazuar në hadithin e Amr ibn Murete el-Xhuheni Allahu qoftë i kënaqur me të i cili thotë: Erdhi tek i dërguari i Allahut një person nga Kuda’a dhe i tha: O i dërguari i Allahut në qoftë se unë dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut dhe se ti je i dërguari i Tij, ti falë pesë kohët e namazit, ta jap zekatin, ta agjëroj muajin e ramazanit dhe të falem gjatë tij atëherë nga cilët lloj besimtarësh jam unë? – ia ktheu i dërguari i Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të:” Je prej të sinqertëve dhe shehidave (dëshmorëve).”

20 – Agjërimi i muajit të ramazanit është shkak për të hyrë në xhennet, transmeton Xhabiri Allahu qoftë i kënaqur me të se një person e pyeti të dërguarin e Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të dhe i tha: Sikur unë ti fali pesë kohët e namazeve, ta agjëroj muajin e ramazanit ta bëj hallallin hallall dhe haramin haram, të mos shtoj më tepër se kaq a do të hyjë në xhennet? – ia ktheu i dërguari i Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të:” Po.” – atëherë ai tha: Për Allahun as nuk do të shtoj e as nuk do të pakësoj prej këtyre veprave. Ky hadith tregon se një person i cili i bën vetëm këto vepra të cilat ia ka obliguar Allahu dhe largohet nga çdo gjë që Allahu ia ka ndaluar hyn në xhennet, kurse ai i cili i len veprat vullnetare-nafile ai humb vetëm mundësi që të fitoj shpërblime akoma më të mëdha, prandaj kanë thënë se ai person i cili vazhdimisht i len veprat vullnetare llogaritet si njeri i dobët ne besimin e tij dhe ky person fillon ti humbë cilësitë e njerëzve të drejtë të cilëve u pranohet dëshmia. Kurse sa i përket fjalës së këtij njeriu:” Nuk shtoj as pakësoj nga këto vepra” mund të kuptohet: Veprimi sipas hallallit që njeriu të vepron sipas sheriatit dhe gjërat që nuk i ndalohen, kurse haram është vepër e ndaluar në përgjithësi. Ndoshta mund të ketë qëllimin të mos merret me nafile nga shkakun se ka qenë i zënë me Xhihad apo me ndonjë vepër tjetër fetare, Allahu e din më së miri.

21 – Kush falet gjatë ramazanit me besim në Allahun dhe shpreson në shpërblimin e Tij i falen mëkatet siç transmeton Ebu Hurejra Allahu qoftë i kënaqur me të se i dërguari i Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të ka thënë:” Kush falet gjatë ramazanit me besim në Allahun dhe shpreson në shpërblimin e tij i falen mëkatet e kaluara.”

Kur falet besimtari gjatë ramazanit me bindje në atë për të cilën ka lajmëruar i dërguari i Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, shpreson shpërblim nga ana e Allahut, kërkon me këtë kënaqësinë e Tij dhe shpreson falje nga Ai, atëherë e arrin këtë shpërblim të madh.

22 – Muaji i ramazanit është muaji i namazit të teravive dhe se namazi i teravive me xhemat nuk falet përveçse në ramazan siç dihet kjo nga i dërguari i Allahu paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të i cili doli një natë në errësirën e madhe të saj dhe u fal në xhami, kur këtë e panë të tjerët u falën pas tij. Njerëzit filluan që të flasin rreth kësaj çështje gjë që rezultoi me rritjen e numrit në natën e dytë, pas asaj nate përsëri u bisedua kjo çështje dhe si pasojë lajmi u përhap edhe më shumë se më herët e kjo solli që në natën e tretë të ketë edhe më shumë njerëz që u falën me të dërguarin e Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të. Derisa natën e katërt i dërguari i Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të nuk doli tua fal namazin sahabëve të cilët thonin: Namazi, namazi...Mirëpo ai përsëri nuk doli derisa erdhi koha e sabahut. Pasi që mbaroi me faljen e sabahut u kthye

nga sahabët dhe u tha:” Mua nuk më ka mërziur çështja juaj, mirëpo pata frikë se mos ju bëhet obligim namazi i natës (namazi i teravisë) e ju të mos të keni mundësi ta falni atë.”(Mutefekun alejhi)

Namazi i teravisë është namaz i ramazanit në fillim të natës, është quajtur “teraviih” sepse në mes katër rekatëve pushohet, këtë kufizim e argumentojmë me hadithin e Aishes Allahu qoftë i kënaqur me te.

23 – Kush e falë teravinë me imam deri sa të mbaron merë shpërblimin sikur të ketë falur namaz tërë natën, gjithsesi kjo është prej begative të Allahut. Transmetohet nga Ebu Dherri Allahu qoftë i kënaqur me të për namazin gjatë ramazanit në të qëndron se i dërguari i Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të ka thënë:” Kush falet me imamin derisa të mbaron imami Allahu ia shkruan këtij personi këtë si namaz nate.” Në një tjetër transmetim:”...i shkruhet namaz nate i plotë.”

24 – Muaji i ramazanit është muaj i fitores së besimtarëve mbi armiqtë e islamit sikur në luftën e Bedrit, siç dihet sahabët në këtë luftë ishin me numër shumë të vogël dhe me përgatitje shumë më të dobët se armiqtë e tyre për këtë qëllim thotë Allahu në Kur’an:” **Dhe më parë Allahu ju nxori ju fitimtarë në Bedër, kur ju ishit një forcë e vogël dhe e dobët. Kështu që kijeni shumë frikë Allahun që të jeni me të vërtetë falënderues. Përkujto kur ti (o Muhamed) u the besimtarëve: A nuk mjafton për ju që Zoti juaj (Allahu) t’ju ndihmojë ju duke ju zbritur tre mijë melekë (engjëj)? Sigurisht, nëse qëndroni me durim edhe përkushtim dhe nëse armiku vërshon e sulet mbi ju, Zoti juaj do t’ju ndihmojë me pesë mijë melekë me shenja të qarta që ti dalloni. Allahu bëri këtë vetëm e vetëm si mesazh përgëzues për ju dhe si qetësues për zemrat tuaja. Dhe nuk ka asnjë fitore vetëm se nga Allahu, i Gjithëfuqishmi, më i Urti Gjithëgjykues.”(Ali Imran:123-126)** Numri i sahabëve në këtë luftë ishte treqind e tridhjetë ushtar, posedonin dy kuaj dhe shtatëdhjetë deve, e Allahu i ndihmoi kundrejt mushrikëve të cilët ishin mbi një mijë ushtarë, posedonin njëqind kuaj, shtatëqindë deve dhe kjo përleshje ndodhi në muajin e ramazanit në vitin e dytë sipas hixhretit. Gjithashtu Allahu i ndihmoi sahabët në betejën e çlirimit të Mekës, e cila ndodhi në muajin e ramazanit në vitin e tetë të hixhretit, ku i dërguari i Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të e çliroi Meken pa luftë. Fitorja vjen nga Allahu e askush tjetër, Allahu pa dyshim se është në ndihmën e të dërguarve të Tij dhe në ndihmë të atyre që besuan, ishin të devotshëm dhe të përkushtuar në fenë e Tij.

Thotë i Lartëmadhërishmi:”...**dhe fitorja nuk vjen përpos se nga Allahu, më Krenari dhe i Urti.**”(Ali-Imran:126) Në një ajet tjetër thotë:”...**e Allahu do ti ndihmoj atij i cili e ndihmon Atë, Allahu është i Fuqishmi dhe më Krenari.**”(Haxh:40)

25 – Ramazani është muaj në të cilin shtohet bujaria, sepse i dërguari i Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të ishte njeriu më bujar kurse bujaria e tij shtohet edhe më shumë në ramazan kur takohej me Xhibrilin alejhi selam, pra bujaria e tij ishte më e lartë në çdo mirësi dhe në çdo vepër i ngjante erës që sjell shiun.(Mutefekun alejhi)

26 - Muaji i ramazanit është për ndryshe edhe muaji i studimit të Kur'anit ngase Xhibrili alejhi selam e takonte të dërguarin e Allahut çdo vit gjatë muajit të ramazanit, kështu që çdo natë ia mësonte Kur'anin të dërguarit të Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të. i dërguari i Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të lexonte kurse Xhibrili alejhi selam dëgjonte dhe e mësonte. Për këtë dëshmon fjala e Ibni Abasit Allahu qoftë i kënaqur me të i cili thotë: i dërguari i Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të ishte njeriu më bujar, posaçërisht kur e takonte Xhibrilin alejhi selam ai vinte çdo natë të ramazanit dhe e dëgjonte leximin e të dërguarit të Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të. Në një transmetim thotë: Kur e takonte i dërguari i Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të Xhibrilin ishte më bujari në veprat e hajrit i ngjante erës që sjell shiun.(Mutefekun alejh)

Transmeton nëna e besimtarëve Aisheja nga Fatimja Allahu qoftë i kënaqur me te e cila thotë: Më tregoi i dërguari i Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të një sekret se Xhibrili ia mësonte Kur'anin çdo vjet kurse këtë vit ma lexoi dy herë dhe me këtë e shoh se më është afruar vdekja.(Buhariu 4997,4998)

27 – Muaji i ramazanit është shtyllë prej shtyllave të islamit, nuk plotësohet e as që pranohet besimi i robit përpos se me të, transmeton Ibni Omeri se i dërguari i Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të ka thënë:” Islami ngrihet mbi pesë shtylla: Dëshmia se nuk meriton të adhurohet askush tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është i dërguari i Tij, falja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimi i ramazanit dhe shkuarja në Haxh.”(Mutefekun alejh)

28 – Muaji i ramazanit është muaji i itikafit-qëndrimit në xhami për të adhuruar Allahun me përkushtim ndaj Tij. Transmeton Aisheja gruaja e të dërguarit të Allahut e cila tregon: i dërguari i Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të bënte itikaf në dhjetë netët e fundit të ramazanit derisa ndërroi jetë, pas tij bënin itikaf gratë e tij.(Mutefekun alejh)

Ebu Hurejra Allahu qoftë i kënaqur me të thotë: i dërguari i Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të e bënte itikafin e tij çdo vit gjatë muajit të ramazanit në dhjetë ditët e fundit kurse në vitin në të cilin vdiq ndëjri njëzet ditë në itikaf.(Buhariu 2044) Thotë Ebu Hurejra Allahu qoftë i kënaqur me të për Xhibrilin se ai ia mësonte çdo vit profetit paqa dhe

mëshira e Allahut qofshin mbi të Kur'anin kurse në vitin që vdiq ia mësoi Kur'anin dy herë gjatë muajit të ramazanit. i dërguari i Allahut paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të në çdo muaj të ramazanit e bënte itikafin në dhjetë ditët e fundit kurse në vitin në të cilin vdiq ndeji në itikaf njëzet ditë. (Buhariu 4998) Pra qëllimi i njëzet ditëve është qëndrimi i dhjetë ditëve të mesme dhe dhjetë të fundit të gjitha përbëjnë njëzet ditë.

29 - Muaji i ramazanit është muaji i përpjekjes për adhurim sepse Pejgamberi salallahu alejhi ve selem gjatë dhjetë ditëve të fundit të ramazanit ishte aktiv në ibadet si në asnjë muaj tjetër, Aisheja radijallahu anha transmeton dhe thotë: “I dërguari i Allahut salallahu alejhi ve selem ishte aq aktiv në dhjetëshin e fundit të ramazanit si asnjëherë më parë”.(Muslimi,1175) Gjithashtu Aisheja radijallahu anha thotë: “kur hynin dhjetë ditët e fundit të ramazanit i dërguari i Allahut e ngjallte natën (me ibadet), i zgjonte edhe familjarët, përpiquej shumë në adhurim dhe e shtrëngonte izarin e tij “. (Mutefekun alejhi)

Kuptimi i fjalës “e shtrëngonte izarin e tij” do të thotë, mendohej dhe bënte ibadet shumë , disa kanë thënë është larguar nga marrëdhëniet intime me gratë e tij. Aisheja radijallahu anha thotë: i dërguari i Allahut salallahu alejhi ve selem ka thënë:”Kërkoni natën e Kadrit në netët tek gjatë dhjetëshit të fundit të ramazanit”, në një transmetim tjetër: kërkoni natën e Kadrit në dhjetëshin e fundit të ramazanit”.(Buhariu 2017,2020). Ndonjëherë mund të jetë nata e Kadrit gjatë netëve çift, siç transmeton Ibn Abasi radijallahu anhu se Pejgamberi salallahu alejhi ve selem ka thënë: Kërkoni në natën e njëzet e katër”.(Buhariu 2021, 2022). Në një transmetim tjetër:”Ajo është në dhjetëshin e fundit, ajo është pas nëntëve të kaluara apo shtatë me bindje”.do të thotë nata e Kadrit, në një transmetim tjetër:”Kërkoni në dhjetëshin e fundit të ramazanit, nata e Kadrit qëndron në të nëntën, në të shtatën, dhe të pestën”.(Buhariu 2021,2022)

Sahabet radijallahu anhu përpjekjet më të mëdha të tyre i bënë në dhjetë netët e fundit të ramazanit , për këtë qëllim Aisheja radijallahu anha ka thënë: O i dërguari i Allahut në qoftë se e di se në çfarë nate është nata e Kadrit çfarë të them? Tha Profeti salallahu alejhi ve selem:” O Allah ti me të vërtetë je Falës Bujar e donë faljen më fal mua”.

30- Prishja e agjërimit gjatë muajit të ramazanit pa arsye nuk është e njëjtë me agjërimit tjera jashtë këtij muaji. Për këtë çështje transmeton Ebu Umameja radijallahu anhu se Pejgamberi salallahu alejhi ve selem ka thënë:” Përderisa isha në gjumë më erdhën dy njerëz, më kapën për beli e më dërguan në një kodër të tmerrshme dhe më thanë: ngjitu! Unë ju thash: nuk mundem . Më thanë: ne do ta lehtësojmë. U ngjita dhe arrita në maje të kodrës ku dëgjova disa zëra të fuqishëm. Pyeta: ç’janë këto zëra? U

përgjigjën: këto janë klithmat e banorëve të zjarrit. Pastaj më dërguan te disa njerëz, të cilët ishin të varur për këmbët e tyre, me gojë të copëtuara, nga të cilat u rridhte gjak. Pyeta: kush janë këta? U përgjigjën: ata të cilët bëjnë iftar para kohe”.

Përktheu: Nexhat Ceka

Redaktoi: Muharem Ismaili